

VENDIM
Nr. 11, datë 27.1.2016

**MBI LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN GENERAL ELETRICITY” SHA, NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç”; 39, pika 3; dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 13, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.1.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian General Eletricity” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian General Eletricity” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian General Eletricity” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti